Procesverbal i mbledhjes date 29.07.2025

Prezent alfredi Gjata, Vladimir Kello, Genti Dmecolli, Lindita Cokani , Trifon Meraku , Oliver Mulla, Festim Kaso , Kledi Cenkolli , Esmeralda Medolli , Oljana Comka , Imelda Cucka , Eroldi Begolli , Ilir Hoxha Valbona Spaho

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1, miratimi i rendit te dites

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 2 , miratimi i procesverbalit te dates 30.06.2025

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 3 Projekt -vendimi Nr 43 dat 23.07.2025 'Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën ekonomike për muajin Qershor 2025" nuk ka diskutime per kete pv.

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 4 Projekt-Vendim Nr.44 Datë 23.07.2025 "Për miratimin e ndihmës financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit nga fondi rezervë i Bashkisë për qytetarët në nevojë e raportit të konsoliduar të Bashkisë Devoll. (Z.Barjam Cucka)"

Nuk ka diskutime .

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 5 Projekt-Vendim Nr.45 Datë 23.07.2025 "Miratimin e përfituesve nga program subvencionimi i interesave të kredisë për strehim."

Genti Dmecolli: Dua te di menyren si eshte njoftuar publiku qe te interesuarit te aplikojne , menyra si eshte perzgjedhur dhe a ka nje fond t caktuar?

Zerina Sinani: Ministria na ka akorduar 10 kuota , pjesa e informimit eshte bere ne faqen zyrtare te bashkise dhe deri tani eshte hedhur dy here. Kanee ngelur dhe 3 kuota te tj deri ne fund te Gushtit. Njoftimi eshte ber gjithashtu dhe ne faqen e fb.Ne kemi kaluar te gjitha kerkesat qe kemi pasur, ne madje presim te plotesohen dhe keto 3 kuota te mbetura .

Eduard Duro: Ne shpresojme qe numri i kuotave te jete me i larte per te pasur sa me shume aplikime.

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 6. Projekt-Vendim Nr.46 Datë 28.07.2025 " Për miratimin e shtesës në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të kalohen në pronësi të Bashkisë Devoll të pasurive nr.482 ZK.1955 fshati Hocisht dhe nr.1027/1 ZK.3129 fshati Qytezë.

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata : Vazhdojme me piken 7 Projekt-Vendim Nr.47 Datë 28.07.2025 " Për dhënien në përdorim të siperfaqes prej 2.968 HA në fondin pyjor/kullosor, për vendosjen e kullave eloike."

Eduar Duro; Eshte nje antikap i VKM i cili i perjashton kullat eolike nga konkurrimi publik, ne kte rast ata duhet te jene te licensuar me leje te posacme. Per prodhimin e energjise eolike. Ky eshte nje antikap pasi nje subjekt nuk mund t kete license pa patur nje toke me qera , kjo vertet eshte per eolike por do tt kaloje ne konkurim dhe formati ne fjale eshte gabim sepse eshte shenuar me emer subjekti .

Te gjithe keshilltaret bien dakord qe te ndryshohet formati hapet votimi

13 pro 1 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata : Vazhdojme me piken 8 Projekt-Vendim Nr.48 Datë 28.07.2025 Për Rishqyrtim "Miratimin projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028."

Ky projektvendim u diskutua dhe ne mbledhjen e pare por per shkak te moszhvillimit te konsultjmeve publike , pavarsisht miratimit u fut perseri per rishqyrtim keshilltaret nuk kan ne ndonje pyetje te re rreth ketij pv edhe dikutimet gjate konsultimeve publike nuk eshte se kishin ndonje kundershtim , ne lidhje me prioritet qe i peopozoi keyetari i Bashkise.

Hapet votimi 14 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Kemi " Barometri i barazise gjinore Bashkia Devoll 2024" , tek pika TE TJERA , *lexohet dhe shpejgohet *

Vazhdojme me nje kerkese nga Vasilika Shallo , sekretaria e keshillit lexon kerkesen.

Alfredi Gjata : Personi ne fjale per te cilin kerkohet titulli qytetar nderi etj, ka qene nje njeri korrekt , ka bere libra etj. Un kam folur dhe me zonjen qe ka bere kerkesen dhe i kam shpejguar qe ka nje procedure dhe duhet kaluar ne disa faza dhe komisione per te pare nese i ploteson kriteret per te marre nje titull te tille.

Trifon Meraku: Une kam bere nje kerkese muajin e pare per dy qytetare nderi, kam dorezuar dhe CV dhe aty ku ka ngecur puna , un kam lexuar dhe ligjin ku thuhet se propozimi mund te behet nga nje keshilltar . I gjithe problemi eshte tek komisioni i Bashkise pasi nuk po e gjejme dot kush eshte ne kete komision ,

Eroldi Begolli: Ne rregulloren e pare te keshillit eshte ngritur komisoni me tre antare gjendja civile dhe 2 keshilltare ne ate kohe. Pastaj me mbrapa jane bere rifresikime apo jo nuke di . Me sa mbaj mend kane qene 3 drejtore shkollash dhe dy keshilltare.

Eduard Duro: Nuk mund te japim me shum se dy tituj qytetar nderi ne vit.

Eduard Duro: Lista e kerkesave per qytetar nderi nuk eshte vetem me dy presona dhe nuk mund te parashtrojme ne keshill nje liste me dy persona kur lista eshte me 10 persona . I lihet kohe komisionit te shqyrtoje te gjithe kerkesat

Imelda Cucka: Keto jane dy propozime qe kane ardhur nga keshilltari Trifon Meraku dhe te gjithe ketu sa ishim, ishim dakort per kontributet e tyre , Trifoni duhet te sjell nje relacion per te dy . Ne momentin qe vjen kerkesa dhe relacioni komisoni i cili duhet rifreskuar ose se ne rast nuk eshte rifreskuar automatikisht merret i mirqene sepse ne kemi caktuar 3 drejtora shkollash 1 keshilltar , keshtu qe komisioni te mblidhet ose te rifreskohet dhe ne rast se i pranon keto kerkesa te sillen si projektvendime .

Do vendoset mbledhjen e ardhshme kush do te jete ne komision.

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Kostandina Brahollí

KB

Mjeda Grafa